



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3085_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2837_01_26** i datës 15.01.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 11.02.2026.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **K. N.**, nga fsh. Zahaq, Komuna e Pejës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2837_01_26 i datës 15.01.2026.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 15.01.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2837_01_26 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit K. N., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 1024136630DPE – 9070733 e dt. 01.11.2024 si dhe korrigjimit financiar me nr. 65870DPE – 9070733 e dt. 11.07.2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori K. N., përmes Av. Burhan Shabanaj, me autorizim, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Njehsori elektrik i konsumatorit me shifër DPE – 9070733 është i vendosur jashtë dhe në atë shtyllë elektrike edhe KEDS ka qasje të plotë 24/7, dhe konsumatori, jo që i ka penguar, por vazhdimisht ka kërkuar nga ekipet e KEDS që të shkojnë, kontrollojnë dhe lexojnë njehsorin elektrik, duke respektuar plotësisht Ligjin për Energji.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximit dhe Korigjimin Financiar nr. 65870DPE-9070733 të datës 11.07.2025, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0007326 date 16.10.2024 si dhe Protokollin e testimit të njehsorit elektrik-elektronik në qendrën laboratorike nr.2235 date 11.04.2025. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve vërtetohet se konsumatori i është bërë regjistrimi i njehsorit elektrik në periudhën 11/2021 si dhe me date 04.11.2021 i është hapur shifra DPE-9070733 duke e faturuar konsumatorin me faturën për shërbime për lidhje të re.

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore por që vërtetohet se në shumicën e periudhave kanë evidentuar lexim “Njehsori brenda, sezonal”, në periudhën 09/2024 kanë evidentuar “Njehsori nuk lexohet/defekt pa shpenzim” kurse në një pjesë të periudhave është evidentuar lexim me sondë dhe manual. Mos qasja në leximin e shpenzimeve mujore është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm”*

Bordi e ka analizuar procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0007326 të datës 16.10.2024 me të cilin vërtetohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për ndërrim njehsori kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 20076335 me gjendje TL=5550 kWh dhe TU=4610 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 40158568 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në vërejtje se: Me urdhëresë të KEDS ndërrohet njehsori dhe vendoset njehsori i ri i cili është teknikisht në rregull. Bazuar në të dhënat e evidentuara në procesverbal vërtetohet se gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 20076335 ka qenë TL=5550 kWh dhe TU=4610 kWh që vërteton se ka pasur shpenzim të energjisë dhe se vërtetohet po ashtu se ekipet e KEDS-it nuk kanë evidentuar asnjë çrregullim të njehsorit elektrik.

Bordi e ka shqyrtuar Protokollin e testimit të njehsorit elektrik-elektronik në qendrën laboratorike nr.2235 date 11.04.2025 me të cilën vërtetohet se ekipet e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 20076335 me gjendje të Shpenzimeve TL=005556 kWh dhe TU=004610 kWh. Të dhënat e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik të evidentuara në këtë procesverbal përputhën plotësisht me të dhënat e evidentuara në procesverbalin e ndërrimi nr. 0007326 të datës 16.10.2024. Në Protokollin e shqyrtimit po ashtu është evidentuar se njehsori elektrik nuk është në rregull dhe është evidentuar vërejtja: ***Njehsori elektrik në lexime softuerike ka të paraqitur vlerë tek OBIS CODE C.52.5 (Value disturbance-1 herë)***. Po ashtu është evidentuar se gabimi në matje të njehsorit elektrik është +0.07 %, DMK konstaton se gabimi i



evidentuar i matjes per njehsorin elektrik nr. 20076335 është brenda kufijve te lejuar te gabimit te përcaktuar me Kodin e Matjes se OSSH-së e qe është +2.5%

Me qellim te sqarimit te vërejtjes se evidentuar ne procesverbalin e shqyrtimit nr.2235 date 11.04.2025, Bordi i ka analizuar edhe të dhënat që DMK i ka kërkuar nga KEDS lidhur me vërejtjen e evidentuar dhe ka pranuar sqarimet si vijon: *“Në lidhje me vërejtjen e evidentuar gjatë testimit të njehsorit elektrik nr. 20076335, përkatësisht paraqitjen e vlerës në OBIS CODE C.52.5 (Value disturbance – 1 herë), ju njoftojmë se kjo vlerë paraqitet si rezultat i ekspozimit/ngacimit të njehsorit nga një fushë elektromagnetike. Ky indikator evidentohet nga sistemi i njehsorit në momentet kur detektohen ndërhyrje të tilla, mirëpo gjatë testimit teknik funksionaliteti dhe saktësia matëse e njehsorit kanë rezultuar në rregull”.*

Më tej, Bordi e ka shqyrtuar korrigjimin Financiar nr. 65870DPE-9070733 të datës 11.07.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit ne KESCO në vlerë prej -184.99€, në të cilin është evidentuar si vijon: *“Lexim jo i rregullt. Shpërndarje e kWh për periudhën 05/2024 deri 10/2024, bazuar ne procesin nr.2235 i datës 11.04.2025 A1=5556 kWh dhe A2=4610 kWh dhe rrjedhën e energjisë elektrike. Njehsori elektrik me nr.20076335 ka te paraqitur vlerën te OBIS Code C.52.5”,* dhe ka gjetur se, ky korrigjim është i saktë si dhe që KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”,*.

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”,* andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, listat e leximit, Procedurën e Leximit dhe Faturimit te konsumatorëve tariforë, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **K. N.**,
- Arkivit të ZRrE-së